

339.5.012.42 (496.5)

Fisnik MUÇA<sup>1</sup>

**PËRFITIMET DHE KOSTOT NGA LIBERALIZIMI I TREGTISË-  
RASTI I SHQIPËRISË**

**ПРИДОБИВКИТЕ И ТРОШОЦИТЕ ОД  
ЛИБЕРАЛИЗАЦИЈАТА НА ТРГОВИЈАТА-СЛУЧАЈОТ НА  
АЛБАНИЈА**

**BENEFITS AND COSTS FROM TRADE LIBERALIZATION- THE  
CASE OF ALBANIA**

**Abstract**

After the Second World War, countries were divided in two blocks: Western block headed by the United States and East bloc countries headed by the Russia and China. Most of the Eastern European states decided that their political and economic system to adapt to communism and socialism. This research paper aims to highlight the transition of the countries from the autarkia to liberalism, taking as an example Albania, one of the only countries in the world that applied isolation policies in terms of the international trade. By using books from authors that have addressed this issue, is given an image of Albania that have turned out from communism and the gradual transition to democracy and capitalism. The official report of the Secretariat of the World Trade Organization(WTO) for Albania 10 years after joining this organization is used to provide macroeconomic data for the changes that have occurred during this period. Also have been used statistical data from the Institute of Statistics of Albania to highlight the benefits of the trade liberalization in terms of import and export of goods. Analyzing all quantitative and qualitative data, we conclude about the costs that had paid Albania as a result of this liberalization based on the events of pyramid schemes and for the benefits in terms of foreign trade and economic development.

Key words: WTO, liberalization, autarkia, export, import.

---

<sup>1</sup> Doktorant në drejtimin: Shkenca Politike në UEJL, Ministria e Drejtësisë, [fnik.muca@hotmail.com](mailto:fnik.muca@hotmail.com)

### **Abstrakt**

Pas Luftës së Dytë Botërore shtetet u ndanë në dy blloqe dhe atë: blloku perëndimor në krye me SHBA-në dhe blloku lindor në krye me Rusinë dhe Kinën. Pjesa më e madhe e shteteve të Evropës Juglindore vendosën që sistemin e tyre politik dhe ekonomik ta përshtatin me komunizmin dhe socializmin. Ky punim hulumtues ka për qëllim të nxjerr në pah kalimin e shteteve nga autarkia në liberalizëm, duke marrë si shembull Shqipërinë, njëri ndër shtetet e vetme në botë që aplikoi skajshmërisht politikën izoluese sa i takon tregtisë ndërkombëtare. Duke përdorur libra të autorëve të cilat kanë trajtuar këtë çështje jepet një imazh i Shqipërisë të dalë nga komunizmi dhe kalimi gradual nëpërmjet tranzicionit drejt demokracisë dhe kapitalizmit. Duke përdorur raportin zyrtar të Sekretariatit të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT-së) për Shqipërinë 10 vjet pas anëtarësimit, jepen vlerësimet dhe të dhënat makroekonomike për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu janë shfrytëzuar edhe të dhënat statistikore nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë për importin dhe eksportin e mallrave me qëllim që të nxirren në pah përfitimet nga liberalizimi i tregtisë. Duke analizuar të gjithë të dhënat sasiore dhe cilësore arrijmë në përfundim për kostot që ka paguar Shqipëria si rezultat i këtij liberalizimi duke u bazuar në ngjarjet e skemave piramidale dhe përfitimet në aspektin e tregtisë së jashtme dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Fjalët kyçe: OBT, liberalizim, autarki, eksport, import

### **Hyrje**

Pas Luftës së Dytë Botërore shtetet kishin nevojë për një rend të ri botëror, për një sistem të sofistikuar të organizatave ndërkombëtare, ku mosmarrëveshjet dhe konfliktet mes shteteve të zgjidheshin në rrugën paqësore. Edhe sa i takon tregtisë, autarkia dhe proteksionizmi nuk shiheshin si strategjitë e duhura tregtare të cilat duhet të aplikoheshin nga ana e shteteve për të rritur fuqinë e tyre. Andaj duke i marrë parasysh të gjithë rrethanat, lindi nevoja për një bashkëpunim mes shteteve në fushën e tregtisë, ku u shfaq nevoja për themelimin e një organizate ndërkombëtare e cila do të merrej me rregullat dhe parimet e tregtisë në nivel ndërkombëtar. Pas dështimit të themelimit të ITO-s (International Trade Organization), SHBA-të dhe disa shtete të tjera vendosën që të nënshkruajnë Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregti dhe Dogana (GAAT). Pas një seri raundesh, në vitin 1995 me përfundimin e raundit të Uruguajit, me Marrëveshjen e Marrakeshit, u vendos që të themelohej OBT-ja.

Parimet dhe rregullat e OBT-së në përgjithësi kanë të bëjnë me çështjet e tregtisë së mallrave, shërbimeve dhe pronësisë intelektuale.

Përfitimet e shteteve nga anëtarësimi në këtë organizatë janë të natyrave të ndryshme, duke nisur nga përfitimet në nivel ndërkombëtar, e deri tek përfitimet e konsumatorëve final. Roli i OBT-së në liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare është i dukshëm me uljen e tarifave doganore në mënyrë graduale dhe krijimin e marrëveshjeve nga fushat e bujqësisë, industrisë, tekstitit, e kështu me radhë. Gjithashtu OBT-ja luan një rol të rëndësishëm edhe në zgjidhjen e shumë mosmarrëveshjeve që lindin mes shteteve si shkak i fërkimit të interesave, ku çdo vit shihen një numër i konsiderueshëm i ankesave dhe padive, të cilat paraqiten përpara Panelit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, si organ kompetent në kuadër të OBT-së.

### **1. Transformimi i rendit ekonomik në Shqipëri nga autarkia në liberalizëm**

Në praktikën e marrëdhënive ndërkombëtare paraqiten tri pikëpamje botërore të mendimeve. Përkrahësit e pikëpamjes *konservatore* dëshirojnë që me çdo kusht të ruajnë gjendjen ekzistuese dhe u japin rëndësi të veçantë ligjeve dhe politikës së shteteve. *Merkanzilizmi* është një pikëpamje konservatore sa i takon tregtisë ndërkombëtare, ku fuqia e shtetit parashihej të rritej duke kufizuar importin dhe duke stimuluar eksportin, me ç' rast saldoja pozitive do të mundësonte hyrjen e arit dhe argjendit në shtet. Përkrahësit e pikëpamjes *liberale* në marrëdhëniet ndërkombëtare vlerësojnë lirinë, sidomos lirinë tregtare dhe shkëmbimet tregtare. *Teoritë klasike apo liberale* sa i takon tregtisë ndërkombëtare derivohen pikërisht nga kjo pikëpamje, ku sipas tyre duhej që të funksionojë “dora e padukshme” e tregut, pra oferta dhe kërkesa. Pikëpamja *revolucionare* mbështetet në transformimin e gjendjes nëpërmjet ndryshimit revolucionar, ku si qëllim final shihet vendosja e drejtësisë. Edhe pse pas Luftës së Dytë Botërore shtetet filluan që të ndërtojnë raporte liberale sa i takon tregtisë, shtetet e bllokut komunist përdornin strategji tregtare të tilla si: autarkia dhe proteksionizmi. Përderisa *proteksionizmi* synon mbrojtjen e industrisë vendase nga konkurrenca ndërkombëtare, autarkia është strategji e cila synon një izolim total nga tregu ndërkombëtar, pra duke u mbështetur në forcat e veta. Njëra ndër shtetet që ndoqi strategjinë tregtare të autarkisë ishte edhe Shqipëria. Joshua Goldstein në librin e tij *Marrëdhëniet Ndërkombëtare Izolimin e Shqipërisë nga tregjet ndërkombëtare dhe rajonale dhe aplikimin e strategjisë së autarkisë e përshkruan kështu: “Në praktikë, kur shtetet janë mbështetur në një politikë autarkie, ata me të vërtetë kanë mbetur*

*prapa të tjerëve. Një rast klasik i dhjetëvjeçarëve të fundit ka qenë shteti i vogël i Shqipërisë, që gjendet ngjitur me Jugosllavinë e pranë Italisë. Kur gjigandët komunistë, Kina dhe Bashkimi Sovjetik u ndanë në vitet 1960, qeveria komuniste e Shqipërisë qëndroi e vetme në anën e Kinës, duke e vendosur Shqipërinë në rrethana të vështira si me fqinjët e saj evropianë perëndimorë, ashtu edhe me ata evropianë lindorë. Shqipëria nuk morri pjesë në tregjet botërore, por u mbështet në një ekonomi të planifikuar nga qendra të parashikuar për t'u mbështetur në forcat e veta. Më pas, në vitet 1970, Shqipëria u shkëput edhe prej Kinës, duke u izoluar krejtësisht. Vendin lejohej ta vizitonin më pak të huaj, tregtia që bëhej ishte e pakët dhe Shqipëria ndoqi rrugën e autarkisë me synimin që t'i ndalonte të huajt që të fitonin pushtet mbi të. Rreth vitit 1991, kur kjo perde izolimi më në fund ra, Shqipëria dukej pothuaj po ashtu siç kishte qenë disa dhjetëvjeçarë më parë. Ishte krijuar shumë pak pasuri në krahasim me atë që kishte pasur; zhvillimi ekonomik që ishte i vogël. Ajo gjendej ndërmjet vendeve më të dobëta të Evropës, si të asaj lindore ashtu edhe perëndimore”<sup>2</sup> Në vitin 1980 kur Kina u hap drejt tregtisë botërore dhe u përmbys modeli i autarkisë, gjë që ndikoi në zgjerimin e shpejtë të tregtisë dhe rritje ekonomike, Shqipëria mbeti e vetme në këtë aspekt. Pas shembjes së diktaturës së Enver Hoxhës dhe kur Shqipëria filloi që të hapet drejt bllokut perëndimor, dolën në pah humbjet dhe pasuria reale që ishte krijuar deri në atë kohë. Shqipëria e viteve 1991 ishte e varfër, me zhvillim tepër të ulët ekonomik dhe popullatë e cila kishte qenë e detyruar të paguante gjithë atë kosto të sistemit.*

Izolimi i Shqipërisë nga tregjet botërore, duke u mbështetur në një ekonomi të planifikuar, si dhe “dashuria” e Enver Hoxhës që kishte ndaj sistemeve komuniste të Kinës dhe Rusisë, çoi deri në atë pikë që Shqipëria të mbetet ndër vendet më të pazhvilluara të Evropës, me qytetarë të cilët kishin një standard të ulët të jetesës, të dënuar që të konsumojnë vetëm se ato produkte që u jepeshin nga ana e shtetit. Këto janë pasojat e një ekonomie të planifikuar dhe një autarkie, ku nga njëra anë ekonomia mbetet e stagnuar, kurse ana tjetër qytetarët e pakënaqur. Sipas Ahmet Mançellarit dy nga kufizimet më serioze të sistemit ekonomik socialist kanë qenë: centralizimi skajor i gjithçkaje në duart e shtetit dhe izolimi skajor i ekonomisë shqiptare nga ekonomia botërore, andaj edhe dy binarët nëpër të cilat duhet të ecte tranzicioni ekonomik në

<sup>2</sup> Joshua S. Goldstein, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, DITURIA, 2003, f. 345.

Shqipëri do të ishin privatizimi i ekonomisë dhe kompletimi i institucioneve që do të mundësonte hapjen e ekonomisë ndaj tregut ndërkombëtar.<sup>3</sup> “Në periudhën dymbëdhjetëvjeçare të izolimit (1978-1990), Shqipëria u nda nga çdo inovacion në fushën e teknologjisë. Borxhi i jashtëm i Shqipërisë deri në fund të vitit 1991 shko në afro 500 milion dollarë duke u rritur vazhdimisht.”<sup>4</sup> Në vitin 1991 me rënien e sistemit komunist pothuajse e gjithë industria ishte shkatërruar, si dhe makineritë e vjetra lindore dhe kineze, dhe mjetet e transportit ishin pothuajse jashtë përdorimit. E gjithë kjo situatë kishte çuar në një stagnim dhe ulje ekonomike, që karakterizohej me përkeqësimin e standardit jetësor, nivel të ulët të konsumit dhe sigurisë sociale, etj.<sup>5</sup>

Tabela nr.1: Importi dhe eksporti në Shqipëri në vitet 1991-1997 në milionë dollarë amerikanë

Vitet	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
<b>VËLLIMI TREGTAR</b>	312.18	394.1	693.6	744.4	918.5	1149.7	779.6
<b>IMPORTI</b>	91.38	72.9	122.4	143.4	204.8	226.4	147.0
<b>Sektori shtetëror</b>	91.38	46.9	62.2	71.4	81.9	40.8	27.7
<b>Sektori privat</b>	0	26	60.2	65.9	120.1	166.4	112.4
<b>EKSPORTI</b>	220.8	321.2	571.2	601.0	713.7	932.3	632.6
<b>Sektori shtetëror</b>	220.8	103.0	126.1	93.3	124.2	152.8	105.0
<b>Sektori privat</b>	0	89.0	294.8	455.3	526.6	741.2	509.5
<b>Ndihmat</b>		124.9	150.3	52.4	62.9	29.3	18.1
<b>DEFICITI TREGTAR</b>	129.4	248.3	448.8	457.6	508.9	696.9	485.6

Burimi: Ahmet Mançellari, “Tregtia Ndërkombëtare”, f. 211

Nga Tabela nr. 1 mund që të shohim që vëllimi i importit në sektorin privat nga viti në vit është në rritje e sipër. Kështu përderisa në vitin 1991 tërë importi realizohej nga sektori shtetëror, në vitin 1997 vetëm se një shumë e vogël realizohet nga ky sektor. Kjo është e ndërlidhur me procesin e privatizimit dhe liberalizimin e tregut të brendshëm. Gjithashtu rritje shihet edhe në vlerat e eksportit, ku përderisa në vitet

<sup>3</sup> Ahmet Mançellari, “Tregtia Ndërkombëtare”, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 209.

<sup>4</sup> Verner Vajdenfeld, “Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore: Strategji për Evropën”, Shtëpia e Librit&Fondacioni Soros, Tiranë, 1999, f. 248.

<sup>5</sup> Po aty, f. 249.

91 eksportuesi i vetëm ishte shteti, në vitet 96-97 eksportuesi më i madh është sektori privat.

## 2. Organizatat ndërkombëtare dhe liberalizimi i tregtisë: Organizata Botërore e Tregtisë

Strategji të suksesshme tregtare llogariten ato që sjellin përfitime reciproke për të gjitha shtetet të cilat bashkëpunojnë, si dhe një mirëqenie për qytetarët. Bashkëpunimi tregtar midis shteteve mund të realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe rajonale, të tilla si zonat e tregtisë së lirë, si dhe regjimet tregtare në formën e organizatave ndërqeveritare shumëpalëshe. Shpresat e përbashkëta të shteteve, për të rregulluar çështjet e tregtisë ndërkombëtare, pa dyshim që mbeten regjimet tregtare.

**Tabela 2:** Organizatat qeveritare prej vitit 1909 deri në vitin 2000

	1909	1954	1962	1970	1981	1988	1996	2000
Organizatat ndërkombëtare	...	...	...	...	31	33	36	35
Organizatat interkontinentale	...	...	...	...	50	45	37	33
Organizatat rajonale	...	...	...	...	255	130	186	172
Aleancat	...	...	...	...	1	1	1	1
Totali i organizatave qeveritare	...	...	...	...	1	1	1	1

Burimi: Geoff R. Berridge, "Diplomacia: Teori dhe Praktikë", f. 187

Nëse analizojnë tabelën nr. 2, do të vërejmë që fill pas Luftës së Dytë Botërore, krijohet një rend i ri botëror, ku numri i organizatave qeveritare është në rritje e sipër. Përderisa para fillimit të LIB, numri i organizatave qeveritare ishte vetëm 37, në vitin 1954 arrin në 118. Në vitin 1981 kemi gjithsej 337 organizata qeveritare ku pjesa dërrmuese janë organizata rajonale. Në vitin 2000 kemi gjithsej 35 organizata ndërkombëtare dhe 172 rajonale.

Qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe deri para fillimit të Luftës së Parë Botërore, ekzistonin organizata ndërkombëtare që kishin

për bazë bashkëpunimin shumëpalësh ekonomik në nivel ndërkombëtar, të tilla si Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (1865), Unioni i Përgjithshëm Postal (1874), Byroja Ndërkombëtare për Peshat dhe Masat (1875), Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtje të Pronës Industriale (1883), Federata Ndërkombëtare e Sindikatave (1901), Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (1906), etj. Edhe në periudhën midis dy luftërave botërore, u themeluan organizata ndërkombëtare ekonomike si: Lidhja e Kombeve (LN), Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), në vitin 1919, Banka për Marrëveshje Ndërkombëtare (1930), etj.<sup>6</sup>

Pas LIIB, organizatat të karakterit ekonomik bëhen ndër aktorët më të rëndësishëm në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Organizata e Kombeve të Bashkuara (1945), e cila ka 192 shtete anëtare, në qëllimet e saja të cilat dalin nga Karta e OKB-së, ka vendosur “bashkëpunimin në zgjidhjen e problemeve ekonomike, sociale, kulturore dhe humanitare në rrafsh ndërkombëtar”, si dhe njëri ndër organet kryesore të kësaj organizate është Këshilli Ekonomik dhe Social, që merret me studimin dhe nxjerrjen e raporteve të natyrës ekonomike. Programet dhe agjencitë autonome të OKB-së, janë ato që përmbushin qëllimin që del nga Karta e OKB-së. Ndër programet kryesore në fushën e ekonomisë janë: UNDP (Programi i KB-së për Zhvillim), UNCTAD (Konferenca e KB-së për Tregti dhe Zhvillim), WFC (Këshilli Botëror i Ushqimit), etj. Disa nga agjencitë autonome të OKB-së janë: Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Agjencia për Garantimin e Investimeve të Huaja (MIGA), Fondi Ndërkombëtar Monetar (IMF), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Organizata Botërore e Tregtisë (WTO) e cila nuk i raporton Këshillit Ekonomik Social, etj.

Njëri ndër regjimet më të rëndësishme tregtare pas Luftës së Dytë Botërore, është Organizata Botërore e Tregtisë, e paraprirë nga Marrëveshja e Përgjithshme për Dogana dhe Tregti (GATT). Sistemi tregtar i pasluftës lindi si rezultat i konfliktit midis negociatorëve amerikanë dhe britanikë në Konferencën e Bretton-Woods-it (1941). Duke ecur në drejtim të hapjes së tregjeve dhe liberalizimit të tregtisë, në Konferencën e Bretton-Woods-it të vitit 1944, përveç themelimit të Fondit

<sup>6</sup> Michael G. Schechter, “Historical dictionary of international organizations”, 2<sup>nd</sup> edition, The Scarecrow Press, United Kingdom, 2010, f. xxvii-xxxix

Ndërkombëtar Monetar (FMN) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, u debatua edhe rreth themelimit të një organizate ndërkombëtare tregtare (International Trade Organization), mirëpo marrëveshja për këtë të fundit nuk u ratifikua nga kongresi amerikan dhe parlamentet e disa vendeve të tjera. Në vend të ITO-s, SHBA dhe 22 vende të tjera, morën vendimin e përbashkët për të lidhur Marrëveshjen e Përgjithshme për Dogana dhe Tregti. Negociatat për themelimin e GATT-it përfunduan më 30 tetor të vitit 1947, kurse marrëveshja hyri në fuqi më 1 Janar 1948. Shtetet të cilat nënshkruan këtë marrëveshje ishin: Australia, Belgjika, Brazili, Burma, Kanadaja, Cejloni, Kili, Republika e Kinës, Kuba, Çekosllovakia, Franca, India, Libani, Luksemburgu, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Pakistani, Indonezia Juglindore, Siria, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>7</sup>

Robert Gilpin duke përmendur faktin që marrëveshja për themelimin e ITO-s (Organizatës Ndërkombëtare të Tregtisë), u hodh poshtë nga Senati amerikan në vitin 1950 dhe që GATT-ti u bë organizata ekonomike kryesore botërore, shton: *“GATT-ti është një sistem tregtar i rregullave fikse, dhe një sistem i tillë i bazuar në rregulla është krejt i ndryshëm prej atij të tregtisë së menaxhuar ose “të orientuar drejt rezultateve” që synon arritjen e objektivave apo të rezultateve sasiore”*.<sup>8</sup> Pra, sistemi tregtar i GATT-it nuk kishte për qëllim arritjet sasiore, por edhe që të promovonte një tregti sa më të lirë dhe më të ndershme, duke krijuar një sistem multilateral tregtar në nivel ndërkombëtar. Themelimi i GATT-it do u jepte fund politikave izoluese dhe proteksioniste, duke ndërtuar një sistem legal ndërkombëtar, ku mosmarrëveshjet midis shteteve dhe problemet me tarifatat doganore të zgjidheshin në mënyrë institucionale.

Të gjitha konferencat e mbajtura në kuadër të GATT-it kanë rëndësinë dhe rolin e vet në funksionimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes dhe reduktimin e tarifave doganore, por raundi në të cilin u morr vendimi për zbritjen lineare të tarifave doganore ishte *“Raundi Kenedi”*. *“Raundi Kenedi solli ulje të barrierave tregtare për prodhimet industriale deri në 33%, si dhe ndihmoi në realizimin e një sërë reformash*

<sup>7</sup> Douglas A. Irwin, Petros C. Mavroidis, Alan O. Sykes, “The genesis of the GATT, Cambridge University Press, New York, 2008, f. 101.

<sup>8</sup> Robert Gilpin, “Ekonomia politike globale: Thelbi i rendit ekonomik ndërkombëtar”, Dita 2000, Tiranë, 2009, f. 191.



bazë, si për shembull rregullimi i praktikave të “dampingut”. Krahas tyre, iu dha një trajtim i privilegjuar eksporteve nga vendet më pak të zhvilluara.”<sup>9</sup> Edhe pse ishte parashikuar një ulje e normave doganore për 50%, realizimi i gjithë kësaj arriti deri në 33%. Gjithashtu një arritje e këtij raundi janë reformat për të rregulluar dampingun, si një mjet kërcënues që pengon liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare. Privilegji që iu dha vendeve më pak të zhvilluara për eksport, është një e arritur e Konferencës së Gjenevës së viteve 1964-1967. Në *Raudin e Tokiosi* cili zgjati prej vitit 1973 deri në vitin 1979, numri i pjesëmarrësve arriti në 102 shtete. Kjo tregon që interesimi i shteteve për tu anëtarësuar në GAAT-in sa vinte rritej, si dhe ardhmërinë e tyre në fushën e tregtisë e shihnin pikërisht në këtë Marrëveshje. Si të gjithë raundet e tjera edhe në këtë raund, iu dha forcë reduktimit të tarifave doganore, ku si rezultat u arrit një ulje mesatare prej 4.7% e tarifës doganore për produktet industriale. Sipas shumë studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Joshua Goldestein, *Raundi Tokio* rezultoi si njëri ndër më të frytshmit pasi që ndikoi jo vetëm në liberalizimin e produkteve bujqësore, por edhe në reduktimin e barrierave jodoganore dhe praktikave jo të ndershme tregtare. Por realisht ky raund nuk qe i suksesshëm nga vetë fakti që në vitin 1970 OPEC-u veçse kishte ngritur çmimet e naftës, gjë që ndikoi në biznesin e eksporteve të automjeteve, me ç’rast paraqitet Proteksionizmi i Ri.

Të gjitha sistemet multilaterale të themeluara pas Luftës së Dytë Botërore kanë rolin dhe rëndësinë e tyre në zgjidhjen e shumë çështjeve dhe mosmarrëveshjeve. Edhe GAAT-ti sikurse organizatat e tjera ka meritën e saj në liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare, si dhe zgjidhjen e shumë mosmarrëveshjeve në këtë lëmi.

Prej vitit 1948 deri në vitin 1994, kur kjo Marrëveshje u shndërrua në OBT, u derivuan një numër i madh i rregullave ndërkombëtare sa i takon tregtisë, por më e rëndësishmja është ajo që fill pas Luftës së Dytë Botërore, ekonomia botërore shënoi një rritje vjetore prej 5 %, kurse tregtia botërore një rritje mesatare vjetore prej 8%. Kurse sa i përket pjesëmarrjes së tregtisë në produktin e përgjithshëm botëror, në vitin 1950 ajo përfshinte vetëm se 7%, përderisa pas një gjysmë shekulli ajo merr pjesë diku me 23% në prodhimin e përgjithshëm botëror. Investimet direkte në vitin 1950 ishin 60 miliardë dollarë, ndërsa sot ato janë

<sup>9</sup> Robert Gilipin, “Ekonomia politike globale: Thelbi i rendit ekonomik ndërkombëtar”, Dita 2000, Tiranë, 2009, f. 193.

më shumë se 350 miliardë dollarë.<sup>10</sup> Raudi i Uruguajit ndryshe njihet edhe si raundi i përmbylljes së raundeve të GAAT-it nga vetë fakti që zgjati plotë tetë vjet, dhe çoi deri në themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë. Në këto negociata morën pjesë gjithsej 123 shtete dhe temat më të diskutuara ishin rreth tarifave doganore, masat jodoganore, rregullat e tregtisë ndërkombëtare, pronësia intelektuale, tekstili, bujqësia, si dhe themelimi i OBT-së. Mund të lindën pyetja: Pse vallë ishte nevoja që të themelohej një organizatë botërore e tregtisë? Arsyet<sup>11</sup> mund t'i radhisim si në vijim:

- Regjimi tregtar i GAAT-it nuk përputhej më me një ekonomi të integruar dhe dinamike, siç ishte ajo e viteve të 1980-ta, nga vetë fakti që avantazhi krahasues vinte çdoherë edhe më shumë në dukje;

- Proteksionizmi i Ri i viteve 1970-tadallonte nga ai i Vjetri nga vetë fakti që barrierat të cilat vendoseshin nga ana e shteteve nuk ishin doganore, por kuota dhe subvencione qeveritare, veprime këto që binin ndesh me parimet dhe rregullat e Marrëveshjes për Dogana dhe Tregti;

- Pesha dhe karakteri i tregtisë ndërkombëtare po ndryshonte, andaj rregullat dhe parimet e GAAT-it veçse ishin të vjetruara dhe kishte hapësirë për plotësime dhe ndryshime. Firmat shumëkombëshe, rritja e vazhdueshme në sektorin e shërbimeve dhe prodhimit, gjithashtu ishin një arsye e fortë që duhej të themelohej një organizatë ndërkombëtare që do të merrej me menaxhimin proceseve dhe rregullave të liberalizimit të tregtisë.

Edhe pse përpjekjet për të përfunduar Raudin e Uruguajit dështuan në pesë takime mes viteve 1990-1994, më në fund u arrit marrëveshja. Arsyet pse dështonin këto takime ishin interesat e shteteve për të mbrojtur ekonominë vendase, por më në fund shtetet evropiane nën presionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës pakësuan subvencionet shtetërore në fushën e bujqësisë. Disa shtete si Franca nuk u tërhoqën nga pikëpamjet e tyre dhe arritën që të fitojnë të drejtën për të mbrojtur industrinë e filmit, kundrejt filmave amerikanë të Holivudit.<sup>12</sup> Pas shumë negociatave midis shteteve, pas takimit të ministrave në vitin 1988 në Kanada ku u arritën disa marrëveshje sa u takonte produkteve

<sup>10</sup> Nasir Selimi, "Globalizimi ekonomik", SEEU, Tetovë, 2008, f. 151.

<sup>11</sup> Robert Gilipin, "Ekonomia politike globale: Thelbi i rendit ekonomik ndërkombëtar", Dita 2000, Tiranë, 2009, f. 194.

<sup>12</sup> Joshua Goldstein, "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", DITURIA, Tiranë, 2003, f. 359

bujqësore<sup>13</sup>, dhe pas shumë ngjarjeve të tjera pasuese, në prill të vitit 1994 në Marakesh të Marokut u arrit marrëveshja për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, e cila filloi së funksionari më 1 Janar të vitit 1995.

### **3. Përfitimet dhe kostot e Shqipërisë nga liberalizimi i tregtisë: Shqipëria pas anëtarësimit në OBT**

Shkaqet të cilat e bëjnë të domosdoshme bashkëpunimin tregtar ndërkombëtar kanë të bëjnë me: rrallësinë apo shpërndarjen e pabarabartë të faktorëve të prodhimit, ndryshimet në shije dhe konsum, ekonomizimet e shkallës, avantazhet absolute dhe realiste të prodhimit, faktorët klimaterik, afërsia ekonomike dhe gjeografike, transferimi ndërkombëtar i teknologjisë, migrimi ndërkombëtar i fuqisë punëtore, e kështu me radhë. Shtetet të cilat transformuan pushtetin e tyre nga komunizmi në demokraci, u ballafaquan me probleme të tilla ekonomike të cilat zgjidhen gjatë periudhës së tranzicionit ekonomik. Sipas Niko Ketrit<sup>14</sup> këto probleme ekonomike janë:

- **Liberalizimi i çmimeve** – largimi i kontrollit shtetëror nga vendosja e çmimeve dhe kujdesi për të ruajtur normën e inflacionit;

- **Privatizimi** – Nga 240 ndërmarrje që ishin projektuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit për tu shitur në ankand gjatë muajve korrik dhe gusht 1993, sipas kësaj metode u shitën vetëm se 8 ndërmarrje, kurse të tjerat iu dhanë pothuajse falas njerëzve të veçantë sepse u konsideruan përjashtime;

- **Ristrukturimi i rendit ekonomik** – Organizimi degësor i ekonomisë kombëtare; si dhe

- **Stabilizimi ekonomik i vendit** – duke stimuluar rritje ekonomike, nxitur investime, duke reformuar sistemin financiar, si dhe duke reduktuar dhe kontrolluar normën e papunësisë.

Liberalizimi i tregtisë së jashtme të Shqipërisë nuk ishte një proces dhe akt i menjëhershëm. Ky proces nisi fillimisht me thyerjen e monopolit shtetëror mbi tregtinë e jashtme, gjë që ka qenë e nisur nga privatizimi dhe liberalizimi i tërësishëm i ekonomisë, fillimisht nga ana juridike me atë të ligjeve të miratuara nga parlamenti demokratik, e pastaj duke u zbatuar gradualisht nga ana e pushtetit ekzekutiv. Në gazetën zyrtare VKM nr. 360 të datës 10.7.1995 në lidhje me importin

<sup>13</sup> WTO, Understanding the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2011, f. 18.

<sup>14</sup> Niko Ketri, “Ekonomia Politike”, UFO Press, Tiranë, 2008, f. 307-315.

dhe eksportin e mallrave shkruhet: *“Importi i mallrave në Republikën e Shqipërisë është i lirë, me përjashtim të mallrave që me akte ligjore e nënligjore ndalohen të futen në Republikën e Shqipërisë. Eksporti i mallrave në R.SH. është i lirë, me përjashtim të mallrave të mëposhtme, eksporti i të cilave është i ndaluar... Ndër mallrat për të cilat ndalohet eksporti, numërohen drutë e zjarrit, trupa druri të papërpunuar dhe lëndë druri e sharruar si dhe mbeturina dhe skrape metalesh të çmuara, si dhe të gizës, çelikut, të bakrit.”*<sup>15</sup>

Liberalizimi i tregtisë dhe anëtarësimi i Shqipërisë në OBT ka qenë i shoqëruar me kosto dhe përfitime. Shikuar në përgjithësi kostot nga liberalizimi i tregtisë janë: ulja e të ardhurave doganore, konkurrenca e sektorëve vendas nga importet dhe kostot e institucionalizimit, strategjitë dhe reformat e nevojshme; kurse përfitimet janë: strategjitë e zhvillimit, përmirësimi i aftësive konkurruese dhe përfitimet e tjera nga marrëveshjet dhe parimet e OBT-së.<sup>16</sup> Kostoja më e madhe nga liberalizimi i tregtisë është e lidhur me uljen e të ardhurave buxhetore nga doganat. Të ardhurat nga doganat janë pjesë përbërëse e buxhetit qeveritar nga njëra anë, kurse nga ana tjetër nënkupton çmim më të lartë për produktet dhe shërbimet në aspekt të konsumatorëve. Gjithashtu edhe konkurrenca nga produktet e importuara paraqet një kosto, por nënkupton një rritje të kualitetit të prodhimit dhe aftësisë konkurruese. Kostot e institucionalizimit dhe strategjitë për liberalizim të tregut kanë qenë një kosto të cilën Shqipëria e ka paguar pak si shtrenjtë në vitin 1997. Mosfunksionimi i duhur i mekanizmave shtetëror për të rregulluar dhe kontrolluar sistemin financiar në Shqipëri çoi deri në rebelimin e vitit 1997 e njohur ndryshe edhe si Kriza Piramidale apo Anarkia në Shqipëri e vitit 1997. Falimentimi i skemave piramidale, një skemë e cila nuk kishte kontrollin e duhur nga ana e shtetit, çoi që shqiptarët të humbnin diku 1.2 miliardë dollarë kursime. Skemat piramidale filluan aktivitetin e tyre në vitin 1991, ku aktiviteti bazohej kryesisht në marrjen e parave nga ana e klientëve dhe kthimi i një sasive parash me një përqindje të lartë interesi. Edhe pse në dukje të parë kjo skemë funksiononte sikurse bankat, në realitet këto firma nuk kishin asnjë investim konkret nga ku mund t'i nxirrnin paratë. Këta fajdexhinj pasi mblodhën paratë e shqiptarëve filluan që të largohen nga Shqipëria, kurse nga ana tjetër këshillat e FMN-së për të mbyllur këta skema as që

<sup>15</sup> Marrë nga: Ahmet Mançellari, “Tregtia Ndërkombëtare”, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 229.

<sup>16</sup> Ahmet Mançellari, “Tregtia Ndërkombëtare”, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 232.

merreshin parasysht nga qeveria shqiptare. E gjithë kjo çoi në rebelimin e popullatës shqiptare që si pasojë u shkaktua një dëm prej 200 milionë dollarëve në dëme materiale, dhe mbi 3800 të vrarë nga të cilët 360 policë, si dhe 5000 të plagosur. Ekonomia e vendit pothuajse u shkatërrua plotësisht, gjë që nxori në pah mungesën e institucionalizimit dhe ndërtimin e strategjive liberale për të kontrolluar tregun financiar sipas rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtar.

Ngjarjet e vitit 1997 ishin një mësim për qeveritë shqiptare që do të vinin në pushtet. Si kurrë më parë doli në pah nevoja e ndjekjes së këshillave të organizatave ndërkombëtare në aspekt të rregullimit të çështjeve ekonomike dhe financiare. Edhe pse Shqipëria ishte anëtare e FMN-së dhe Bankës Botërore qysh prej vitit 1991, nevoja për të qenë anëtare e OBT-së ishte e domosdoshme. Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të karakterit ekonomik dhe respektimi i parimeve dhe rregullave të këtyre organizatave do të krijonte edhe stabilitet të brendshëm. Anëtarësimi në OBT do të ndihmonte në thithjen e investimeve dhe ngritjen dhe zgjerimin e eksportit. Përfitimet nga rregullat dhe marrëveshjet e OBT-së do të mundësonin që Shqipëria të ishte një vend i sigurt dhe stabil në skenën tregtare ndërkombëtare.

Shqipëria nga aplikuar për anëtarësim në GAAT qysh në vitin 1992. Negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në OBT filluan në fillim të vitit 1998. Rezultatet finale të negociatave përfunduan në 17 Korrik të vitit 2000, me ç'rast më 8 Shtator 2000, Shqipëria u bë vendi i 138-të i OBT-së. Drejtori gjeneral i asaj kohe Mike Moore me rastin e anëtarësimit të Shqipërisë përshëndeti këtë ngjarje duke thënë: *“I dëshiroj mirëseardhje Shqipërisë në sistemin shumëpalësh tregtar. Anëtarësimi premtion një ardhmëri me perspektivë dhe rritje të standardit jetësor për qytetarët shqiptar. Gjithashtu besoj që duke inkurajuar raportet tregtare mes vendeve, OBT-ja mund të ndihmojë në nxitjen e një paqe më të madhe, stabiliteti dhe zhvillimi në vendet e Evropës Juglindore. Anëtarësimi i Shqipërisë i sjell kësaj organizate kuptimin e vërtet e një Organizate Botërore të Tregtisë”*<sup>17</sup> Ky fjalim i drejtorit gjeneral me rastin e anëtarësimit të Shqipërisë në OBT është shumë domethënës. Anëtarësimin e Shqipërisë në OBT e ndërlihdh me paqen, sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin në Evropën Juglindore, gjë që të jep

<sup>17</sup> WTO News, 2000 Press Releases, 8 September 2000, marrë nga [https://www.wto.org/english/news\\_e/pres00\\_e/pr189\\_e.htm](https://www.wto.org/english/news_e/pres00_e/pr189_e.htm), me datë 12.12.2015.

të kuptosh që Shqipëria luan një rol të rëndësishëm në rrafsh rajonal sa i takon stabilitetin të rajonit.

Në vitin 2010 Sekretariati i OBT-së ka lëshuar raportin për ecuri-në 10 vjeçare të Shqipërisë në aspekt të zhvillimit ekonomik, liberalizimit tregtar, uljen e tarifave doganore, të dhënave makroekonomike, etj. Sipas këtij raporti gjatë viteve 2002-2009, Shqipëria ka arritur rritje ekonomike solide me diku 5.8%, gjë që ka qenë e shoqëruar me rritjen e kërkesës së brendshme, depërtimin e investimeve të huaja direkte dhe remitancat. Gjithashtu shkruan që Shqipëria ka reduktuar borxhin qeveritar, duke rritur të ardhurat nga taksat, uljen e papunësisë dhe duke mbajtur në nivel normën e inflacionit, të gjithë këto rekomandime të Bankës Botërore. Përgjatë dy dekadave, prej një tregu të mbyllur dhe ekonomi të centralizuar, sot ajo është e lirë dhe e orientuar nga tregu, e udhëhequr nga sektori privat.<sup>18</sup>

**Tabela 3:** Indikatorët kryesor ekonomik 2002-2008

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
<b>GDP-ja sipas çmimeve të tregut(lekë milionë)</b>	622,711	694,098	750,785	814,797	882,209	966,651	1,087,867
<b>GDP-ja aktuale(në milionë dollarë)</b>	4,443.1	5,695.7	7,305.0	8,158.5	8,992.7	10,689.7	12,967.1
<b>GDP-ja akutale(në milionë euro)</b>	4,704.6	5,047.7	5,880.5	6,561.0	7,167.7	7,819.2	8,858.6
GDP-ja sipas sektorëve, çmimet bazë	% rritja në përqindje						
<b>GDP-ja reale</b>	4.4	6.0	5.7	5.7	5.4	5.9	8.0
<b>Bujqësi, gjueti dhe pylltari</b>	2.1	2.9	6.3	0.9	3.1	2.6	7.7
<b>Industri</b>	-5.9	29.0	14.1	11.7	12.1	-10.3	9.4
<b>Ndërtimtari</b>	21.5	23.4	7.9	6.3	10.5	10.1	4.8
<b>Shërbimet</b>	3.8	0.6	2.8	6.2	4.2	9.4	8.4
GDP-ja sipas shpenzimeve	% rritja reale në përqindje, çmimet e tregut						
<b>GDP</b>	4.2	5.8	5.7	5.7	5.4	6.0	7.8

<sup>18</sup> WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for Albania, Trade Policy Review Body, October, 2010, f. 1.

CENTRUM 4

<b>Kërkesa e brendshme, kontributi në rritje %</b>	13.0	17.2	10.0	10.4	11.0	15.3	---
<b>Konsumi privat</b>	13.3	12.0	12.2	8.5	7.2	13.9	12.6
<b>Konsumi i NPISH-së</b>	14.3	14.3	14.2	14.2	15.0	8.3	12.6
<b>Konsumi publik</b>	14.7	8.6	9.1	7.3	1.02	10.0	1.5
<b>Formimi i kapitalit fiks bruto</b>	5.5	19.0	-0.5	7.9	14.1	9.0	6.9
<b>Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve</b>	28.4	11.4	-2.0	19.4	3.6	24.2	12.2
<b>Eksporti i mallrave dhe shërbimeve</b>	13.5	15.8	16.8	12.6	18.3	23.7	17.6
<b>Importi i mallrave dhe shërbimeve</b>	21.4	13.3	6,5	16.1	10.7	24.0	14.9
GDP-ja sipas tipit të shpenzimeve				% e GDP-së akutale			
<b>Konsumi privat</b>	74.7	75.1	77.9	77.9	77.1	80.2	80.2
<b>Konsumi qeveritar</b>	11.2	10.9	11.0	10.9	10.1	10.2	9.2
<b>Konsumi i NPISH-së</b>	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2
<b>Formimi i kapitalit fiks bruto</b>	37.9	40.5	37.2	37.0	39.0	38.8	36.8
<b>Eksporti neto i mallrave dhe shërbimeve</b>	-24.7	-24.7	-22.4	-24.6	-23.6	-26.7	-26..7
<b>Eksporti i mallrave dhe shërbimeve</b>	19.6	20.4	22.0	22.8	24.9	28.2	29.4
<b>Importi i mallrave dhe shërbimeve</b>	44.3	45.1	44.4	47.5	48.5	54.9	56.1

Burimi: WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for Albania, Trade Policy Review Body, October, 2010

Ekonomia shqiptare është e udhëhequr nga sektori i shërbimeve (përfshirë ndërtimtarinë) në vitin 2008. Në sektorin e shërbimeve kontribut më të madh kanë dhënë: shitjet tregtare, shitja dhe riparimi i makinave, hotelet, restorantet. Zgjerimi i bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë është i mjaftueshëm, por ka rënie prej vitit 2002 në vitin 2008. Ndërtimtari ka rritje prej 12% të GDP-së në vitin 2002 në 14% në vitin 2008. Sektori i prodhimtarisë mbetet i ulët duke kontribuar vetëm se me 9% në GDP-në në vitin 2008.

**Tabela 4:** Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

	Eksporte	Importe	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
2000	37.037	157.109	-120.072	23,6
2001	44.096	190.155	-146.059	23,2
2002	47.490	210.368	-162.878	22,6
2003	54.487	225.983	-171.496	24,1
2004	62.121	236.072	-173.951	26,3
2005	65.818	262.191	-196.373	25,1
2006	77.405	299.147	-221.742	25,9
2007	97.171	376.194	-279.023	25,8
2008	112.572	439.894	-327.322	25,6
2009	104.515	428.839	-324.324	24,4
2010	161.548	477.768	-316.220	33,8
2011	196.897	544.004	-347.107	36,2
2012	213.030	528.490	-315.460	40,3
2013	246.398	517.378	-270.980	47,6
2014	255.759	552.279	-296.520	46,3

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë

Nga Tabela nr. 4 mund që të konkludojmë që prej vitit 2000 deri në vitin 2014 kemi një rritje graduale të importit dhe eksportit të mallrave. Edhe pse realisht ka një rritje të deficitit tregtar, realisht norma e mbulimit të eksportit me import është rritur. Përderisa në vitin 2000 rritja e mbulimit ishte vetëm se 23.6%, në vitin 2014 ajo përfshin normën prej 46.3%, që nënkupton një stabilitet më të madh në bilancin tregtar. Importuesi më i madh i Shqipërisë ndër vite ka qenë Italia me diku 51% të vlerës totale të eksportit në vitin 2010, pastaj Kosova me 6.2%, Greqia 9.5%, Turqia me 1.3%, Kina me 1.1%. Sa i takon eksportuesve më të mëdhenj drejt tregut shqiptar në vitin 2010 vendin e parë e zë Italia me 28.6%, Greqia me 13.1%, Kina 5.9%, Turqia 5.6%, Gjermania 5.5%.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Instat, Tregtia e Jashtme 2006-2010, Instat, 2011.



### **Përfundim**

Nga e gjithë kjo që u elaborua në këtë punim hulumtues mund që të konkludojmë që autarkia dhe proteksionizmi nuk janë strategji të cilat duhet të ndiqen nga ana e shteteve sa i takon tregtisë ndërkombëtare. Kjo gjë është vërtetuar me Shqipërinë e cila aplikoi politika izoluese të tregtisë së jashtme, ku me rënien me komunizmit dolën në pah të gjitha humbjet dhe dështimet. Sikur Shqipëria të ishte orientuar drejt politikave liberale dhe demokracisë qysh më herët, ndoshta sot do të ishte pjesë e Bashkimit Evropian duke konkurruar me disa shtete të Evropës. Fill pas rënies së komunizmit në vitin 1991 nisën edhe hapat e para drejt zhvillimit ekonomik dhe privatizimit, mirëpo izolimi i skajshëm reflektoi që të ndodhte rebelimi i vitit 1997, ku dështimi i skemave piramidale rrezikoi ardhmërinë e shtetit shqiptar. Sot, Shqipëria është shtet anëtar i shumë organizatave ndërkombëtare përfshirë këtu OBT-në dhe NATO. Liberalizimi i tregtisë në Shqipëri ka nxjerr në pah shumë përfitime si në aspekt të përmirësimit të të dhënave makroekonomike, po ashtu edhe në aspekt të kompanive të mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu edhe konsumatorët nuk janë privuar nga këto përfitime duke konsumuar ato produkte dhe duke shfrytëzuar ato shërbime të cilat i kanë për shije. Shqipëria shihet si një vend atraktiv për turizëm, kurse ka një avantazh të madh në eksportimin e shërbimeve.

### **Literatura e shfrytëzuar**

1. Joshua S. Goldstein, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, DITURIA, 2003.
2. Ahmet Mançellari, “Tregtia Ndërkombëtare”, SHBLU, Tiranë, 1999.
3. Verner Vajdenfeld, “Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore: Strategji për Evropën”, Shtëpia e Librit&Fondacioni Soros, Tiranë, 1999.
4. Michael G. Schechter, “Historical dictionary of international organizations”, 2<sup>nd</sup> edition, The Scarecrow Press, United Kingdom, 2010.
5. Douglas A. Irwin, Petros C. Mavroidis, Alan O. Sykes, “The genesis of the GATT”, Cambridge University Press, New York, 2008.
6. Geoff R. Berridge, “Diplomacia: Teori dhe Praktikë”, Kolegji Universitar “VICTORY”, Prishtinë, 2007.
7. Robert Gilpin, “Ekonomia politike globale: Thelbi i rendit ekonomik ndërkombëtar”, Dita 2000, Tiranë, 2009.

8. Nasir Selimi, "Globalizimi ekonomik", SEEU, Tetovë, 2008.
9. Niko Ketri, "Ekonomia Politike", UFO Press, Tiranë, 2008.
10. WTO, Understanding the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2011.
11. WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for Albania, Trade Policy Review Body, October, 2010.
12. WTO News, 2000 Press Releases, 8 September 2000, Marrë nga [https://www.wto.org/english/news\\_e/pres00\\_e/pr189\\_e.htm](https://www.wto.org/english/news_e/pres00_e/pr189_e.htm), me datë 12.12.2015.
13. Instituti i Statistikave të Shqipërisë, <http://www.instat.gov.al/>
14. Instat, Tregtia e Jashtme 2006-2010, Instat, 2011.